

Nr. Re nd or	Data e regjist rimit	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përmbajtja e përgjigjes	Mënyra e përfundimit të kërkesës (E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar)	Tarifa e shërbimit
Periudha Janar 2025						
1	20.01.2025	Kërkohet informacion mbi thirrjen e ekselencës	03.02.2025	Përgjigja nr. 1 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

2	28.01.2025	Kërkohe informacion mbi vendimin e një Komisioni Disiplinor të një institucioni të pavarur	30.01.2025	Deleguar te organi kompetent	Deleguar	Nuk ka
3	03.02.2025	Kërkohe informacion mbi kriteret e disa pozicioneve të caktuara në një institucion publik	17.02.2025	Nga të dhënat që administrojmë rezulton se, referuar urdhrit nr.14, datë 25.1.2024 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, Sektori i Koordinimit dhe Integritit, në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përbëhej nga një përgjegjës sektori dhe dy specialistë. Kriteri i llojit të arsimit për të dyja pozicionet Specialist ka qenë në fushën ”Arsim i Lartë”. Për periudhën 25.01.2024-23.10.2024 nuk ka pasur pozicione vakante në këtë sektor. Me ndryshimin e strukturës me urdhrin nr.205, datë 23.10.2024 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, në Sektorin e Koordinimit dhe Integritit u shtua dhe një pozicion tjetër specialist, pra sektori përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe tre specialist. Referuar përshkrimeve të punës, një pozicion specialist ka të përcaktuar llojin e arsimit në fushën “Arsim i Lartë”, për dy të tjerët fusha e arsimit është në “Shkenca Mjekësore/Shkenca Sociale/Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike”. Ndërkohë prej datës 23.10.2024 vetëm një pozicion rezulton të jetë vakant i cili është shpallur në faqen e Departamentit të Administratës Publike (DAP), me kodin 6707- Lloji i diplomës "Shkenca Mjekësore/Shkenca Sociale/Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike", niveli minimal i diplomës "Master Profesional", sipas linkut https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6338/2/5. Kjo procedurë konkurrimi është ende në proces.	E plotë	Nuk ka

4	10.03.2025	Kërkohet informacion mbi shuarjen e një mase disiplinore	17.03.2025	Përsëndetje z. B., Në përgjigje të kërkesës tuaj me e-mailin e datës 10.03.2025, nëpërmjet së cilës kërkon informacion lidhur me fillimin e shuarjes së masës disiplinore, kur jepet masa e parashikuar në germën “c”, të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ju bëjmë me dije se: Neni 61, i ligjit nr. 152/2013, të sipërcituar, parashikon në mënyrë të qartë afatet dhe procedurën për shuarjen e masës disiplinore për një nëpunës civil. Më konkretisht në këtë dispozitë përcaktohet se: “Shuarja e masave disiplinore 1. Masat disiplinore shuhen, për shkak të ligjit, pas kalimit të këtyre afateve: a) 2 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar në shkronjën “a” të nenit 58 të këtij ligji; b) 3 vjet nga mbarimi i afatit, për të cilin është zbatuar masa e parashikuar në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 58 të këtij ligji; c) 7 vjet nga njoftimi i masës së parashikuar sipas shkronjës “ç” të nenit 58 të këtij ligji. 2. Deklarimi i shuarjes bëhet kryesisht apo me kërkesë, me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi është i punësuar, apo të DAP-it, në rastin e anëtarëve të TND-së. Masa fshihet nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës.” Për sa më sipër, në rastin e dhënies së një mase disiplinore “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.”, afati 3 (tre) vjeçar fillon të llogaritet nga përfundimi i periudhës për të cilën është dhënë masa. Theksojmë se, në rast paqartësish lidhur me vendimin e Komisionit të Disiplinës dhe masën e dhënë, nëpunësi mund t’i drejtohet autoritetit kompetent pranë të cilit është ngritur komisioni. Si përfundim, ju bëjmë me dije se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2025 të DAP-it, me numrin rendor 4, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t’i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, Departamenti i Administratës Publike	E plotë	Nuk ka
---	------------	--	------------	---	---------	--------

5	10.03.2025	Kërkohe informacio n mbi pagat në administrat ën publike, deleguar pjesërisht nga një institucion tjetër	21.03.2025	Përgjigja nr. 2 bashkëlidhur	E pjesshme (Nuk disponohet gjithë informacioni)	Nuk ka
---	------------	--	------------	------------------------------	---	--------

6	17.03.2025	Kërkohet informacion mbi përmbajtjen e vendimeve të Komisionit të Disiplinës	01.04.2025	Përsëritet z. B., Në përgjigje të kërkesës tuaj me e-mailin e datës 17.03.2025, nëpërmjet së cilës kërkon informacion lidhur me përmbajtjen e vendimit të Komisionit të Disiplinës dhe rastet e paligjshmërisë së tij, kur jepet masa e parashikuar në germenin “c”, të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ju bëjmë me dije se: Përmbajtja e vendimit përfundimtar të Komisionit Disiplinor në shërbimin civil, përcaktohet shprehimisht në pikën 19, të Kreut II, të Vendimit nr. 115 datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të ndryshuar. Më konkretisht në këtë dispozitë përcaktohet se: “19. Vendimi përfundimtar i organit disiplinor përmban këto të dhëna: a) organin që ka marrë vendimin; b) identifikimin e nëpunësit ndaj të cilit është marrë masa; c) masën e marrë; ç) shkeljen faktike; d) bazën ligjore; dh) arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve që janë bërë shkas për marrjen e vendimit; e) rastet e mëparshme të shkeljeve të ngjashme dhe të masave disiplinore të marra; ë) një listë dhe kopje të të gjitha dokumenteve që mbështesin masën disiplinore të dhënë, nëse këto kërkojnë nga nëpunësi nën procedim; f) të drejtën që ka nëpunësi i ndëshkuar për t’u ankuar dhe afatet e ankimit.” Theksojmë se, në rast pretendimesh për mangësi në përmbajtjen e vendimit të Komisionit të Disiplinës, nëpunësi mund t’i drejtohet gjykatës kompetente e cila, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, disponon lidhur me ligjshmërinë e aktit administrativ. Si përfundim, ju bëjmë me dije se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2025 të DAP-it, me numrin rendor 6, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t’i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al	E plotë	Nuk ka
---	------------	--	------------	---	---------	--------

7	01.04.2025	Kërkohet informacion mbi nëpunësit që kanë dhënë dorëheqjen për të kandiduar në zgjedhje	14.04.2025	Në vijim të kërkesës tuaj për informim, bazuar në ligjin nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar, në lidhje me listën e zyrtarëve që disponojmë, të cilët në zbatim të Kodit Zgjedhor, kanë dhënë dorëheqje në kuadër të kandidimit të tyre për deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, si dhe listën e zyrtarëve që disponojmë të cilët janë angazhuar për të qenë anëtarë të KZAZ dhe administrimit zgjedhor, Departamenti i Administratës Publike (DAP), ju bën me dije si vijon: Së pari, vlerësojmë të sqarojmë se mbështetur në nenin 4, pika 1, gërma "f", të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike (DAP) është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil. Referuar përcaktimeve të nenit 4 të ligjit të sipërcituar "institucion i administratës shtetërore" konsiderohet aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit. Së dyti, referuar pikave 1/d dhe 3 të nenit 54, të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe kreut I, të VKM nr. 124, datë 17.02.2016 "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil", i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore të institucionit ku nëpunësi është emëruar, duhet të konstatojë pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit civil, në rast se regjistrohet, sipas ligjit, si kandidat për zgjedhjet vendore apo politike, për periudhën nga regjistrimi deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në përfundim të mandatit. Për anëtarët e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND-së), konstatimi i pezullimit bëhet me marrjen dijeni për shkakun e pezullimit, nga DAP-i. Gjithashtu, në zbatim të pikës 14, të kreut I, të vendimit nr. 124, datë 17.02.2026, për institucionet e administratës shtetërore, njësia e burimeve njerëzore njofton njësinë përgjegjëse për pezullimin e nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët apo të mesme drejtuese, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e konstatimit apo miratimit të pezullimit. Së treti, neni 6, pika 2 e Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përcakton se punonjësi i administratës shtetërore i cili është regjistruar si kandidat për zgjedhjet pezullohet nga detyra nga momenti i regjistrimit të tij si kandidat deri në datën e përfundimit të numërimit të votave në zonën ku kandidon. Për nëpunësit, marrëdhënia e punës të të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës, në rastet kur nuk njoftojnë për kandidimin në zgjedhje, merret masa e ndërprerjes e marrëdhënies së punës. Në kuptim të sa më sipër, nga të dhënat që Departamenti i Administratës Publike administron, rezultojnë se janë pezulluar marrëdhëniet në shërbimin civil për shkak të ligjit, për arsye të regjistrimit si kandidat për deputet në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, nëpunësit civil si më poshtë: 1. A. F; 2. P. A; 3. A. I.; 4. E. A; 5. B. M;6. A. B. Ndërkohë nuk administrojmë asnjë të dhënë lidhur me angazhimin e nëpunësve në përbërjen e KZAZ-ve, KQV-ve apo të GNV-ve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 deri në datën e dërgimit të këtij email-i.	E plotë	Nuk ka
---	------------	--	------------	--	---------	--------

8	02.04.2025	Kërkohe t informacio n lidhur me kuadrin rregullator dhe të dhënat lidhur me zbatimin e rregullave të etikës dhe këshillimit në administratën publike	08.04.2025	Përgjigja nr. 3 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
9	17.04.2025	Kërkohe t informacio n lidhur me të drejtat politike të nëpunësve civilë.	29.04.2025	Përgjigja nr. 4 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
10	25.04.2025	Kërkohe t informacio n lidhur me disa procedura rekrutimi	30.04.2025	Përgjigja nr. 5 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

11	02.06.2025	Kërkohet informacion lidhur me rekrutimin e drejtuesve të lartë në administratën shtetërore	17.06.2025	Përgjigja nr. 6 bashkëlidhur	E kufizuar (Një pjesë e informacionit refuzuar pasi cënon të drejtën për privatësi të personave të tretë)	Nuk ka
12	12.06.2025	Kërkohet informacion lidhur me një procedurë rekrutimi në shërbim civil	16.06.2025	Përgjigja nr. 7 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka

13	28.07.2025	Kërkohe informacio n lidhur numrat e punonjësve të administrat ës dhe nëpunësit civilë	11.08.2025	Përshëndetje, Në përgjigje të kërkesës suaj për informim të datës 28.07.2025, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon: Së pari, vlerësojmë të sqarojmë se mbështetur në nenin 4, pika 1, gërma “f”, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike (DAP) është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil. Referuar përcaktimeve të nenit 4 të ligjit të sipërcituar “institucion i administratës shtetërore” konsiderohet aparati i Këshillit të Ministrave, ministritë, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshirë degët e tyre territoriale, si dhe administrata e prefektit. Referuar kërkesës suaj mbi numrin e zyrtarëve publikë që nuk përfshihen në shërbimin civil për vitet 2023 dhe 2024, DAP informon se, në përputhje dhe me përcaktimet e nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar nuk i disponon këto të dhëna. Lidhur me këto të dhëna mund t'i referoheni ligjit vjetor të buxhetit dhe/apo pranë INSTAT. Sa i përket të dhënave për nëpunësit civilë, DAP ju informon se nga të dhënat që administron rezulton se numri i nëpunësve civilë për vitin 2023 ka qenë 6489 nëpunës civilë dhe për vitin 2024 ka qenë 6093 nëpunës civilë. Ritheksojmë se ky numër i referohet institucioneve për të cilat DAP është njësi përgjegjëse. Si përfundim, ju sqarojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2025 të DAP-it, me numrin rendor 13, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

14	21.08.2025	Kërkohet informacion lidhur me kërkesat për pezullim nga nëpunësit civilë për vitet 2021, 2023 dhe 2025	03.09.2025	Përgjigja nr. 8 bashkëlidhur	E plotë	Nuk ka
15	10.10.2025	Kërkohet informacion lidhur me shpalljet e programit të ekselencës ndër vite	23.10.2025	Përsëritje z. H. Në vijim të komunikimeve tona lidhur me kërkesën tuaj për informim ju sqarojmë se, DAP ka përgatitur informacionin e kërkuar nga ana juaj dhe ju ka informuar për mënyrën e tërheqjes së tij, me e-mailin e datës 23.10.2025. Ashtu si ju kemi sqaruar dhe me e-mailin e datës 28.10.2025, përcjellja e këtij informacioni nëpërmjet e-mailit nuk është efektive, prandaj dhe në kuadër të parimit të transparencës dhe të drejtës për informim, është siguruar përgatitja e këtij informacioni voluminoz, në një format të përshtatshëm, përmes së cilës informacioni mund t'ju vihet në dispozicion në mënyre efektive. Theksojmë se, pavarësisht kërkesave tona të përsëritura, mënyra e vetme e kontaktit e cila na është vënë në dispozicion është e-maili juaj, prandaj dhe çdo komunikim nga ana e DAP-it është dërguar në këtë e-mail. Për sa më sipër, Departamenti i Administratës Publike i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij, referuar ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar, sipas afateve dhe parashikimeve të përcaktuara në ligj. Si përfundim, ju informojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2025 të DAP-it, me numrin rendor 15. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.	E plotë	Nuk ka

16	13.10.2025	Kërkohet informacion lidhur me një procedurë konkurrimi për një nëpunës publik	13.10.2025	Personelet, Në vijim të kërkesës suaj për informacion referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike(DAP), ju sqaron si vijon: Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, DAP ka publikuar procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë me kod 7224, për pozicionin: “Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Sigurisë Fizike të Informacionit, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, klasa e pagës II-1”. Me përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele pa kandidatë fitues, në përputhje me pikën 22 e në vijim të kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, njësia përgjegjëse DAP bëri verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kushtet dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Për këtë pozicion kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon: a - Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo "Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Arsim i Lartë; b - Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e informacionit të klasifikuar; c - Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze; d - Të plotësojnë kriteret për t'u pajisur me CSP sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar. Njësia përgjegjëse, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, ka verifikuar kandidatët që përmbushin kushtet dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Në përfundim të procedurës së verifikimit kanë rezultuar tre kandidatë të cilët kanë plotësuar dhe janë kualifikuar për të vijuar me fazën e dytë të konkurrimit. https://relutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6991/4/12	E plotë	Nuk ka
17	20.10.2025	Kërkohet informacion lidhur me procedurën e fundit për anëtarët TND	Proces	Proces	E plotë	Nuk ka

18	22.10.2025	Kërkohet informacion lidhur me shtesën e koordinatoreve për të drejtën e informimit	Proces	Proces	E plotë	Nuk ka
19	23.10.2025	Kërkohet informacion lidhur me disa punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	Proces	Proces	E plotë	Nuk ka
20	31.10.2025	Kërkohet informacion lidhur me punonjësit e administratës publike	Proces	Proces	E plotë	Nuk ka